

2014

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR



LISTA E BARNAVE TË RIMBURSUARA

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM
TË KUJDESIT SHËNDETËSOR**

LISTA E BARNAVE TË RIM- BURSUARA

2014

PARATHËNIE

Lista e barnave të rimbursuara e vitit 2014, është një pjesë e rëndësishme e paketave të shërbimit që mbulon Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për popullatën. Lista e barnave të rimbursueshme ka si qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimit për të gjithë pacientët e në mënyrë të posaçme për shtresat në nevojë. Në këtë këndvështrim, FONDI synon përmes listës së re të barnave, të shtojë vëmendjen drejt kategorive si pensionistët, por këtë vit në fokus janë gjithashtu fëmijët, gratë shtatzëna, të sëmurët me kancer, të sëmurët me probleme të shikimit etj.

Në hartimin e listës së re të barnave janë marrë parasysh disa kritere shkencore, duke i dhënë prioritet barnave të cilat përdoren për sëmundje të rënda; sëmundje me rrezikshmëri të lartë për jetën; sëmundje që shkaktojnë invaliditet; sëmundje që kanë rrezikshmëri përhapje në shoqëri; sëmundje që shkaktojnë shumë vuajtje si dhe sëmundje kronike që kërkojnë mjekim të zgjatur.

Lista e vitit 2014 është pasuruar me 56 barna të reja, të cilat shërbejnë për sëmundje si diabeti, anemitë, sëmundjet kardiake, gjithashtu në trajtimin e disa sëmundjeve tumorale, nëneurologji, nënefrologji, në kujdesin paliativ, në dermatologji, gjinekologji, urologji, shëndetin mendor, alergjologji dhe okulistikë.

Risia e këtij viti është gjithashtu mbulimi i disa nozologjive të pambuluara më parë, si, disa lloje tumoresh, Hepati B dhe C, çrregullimet hormonale, osteoporoza etj.

Lista e barnave të rimbursuara është ndërtuar mbi parimin e listës thelbësore të barnave të OBSH-së, për të mënjeluar efektet negative të tregut farmaceutik dhe për të ndihmuar mjekët në trajtimin me medikamente të të sëmurëve. Lista përmban barna të cilat kanë masë mbulimi të përcaktuar sipas grupeve, që varion nga 50% në 100% të çmimit të referencës.

Ky botim ju vjen në ndihmë të gjithë aktorëve që japin dhe marrin shërbimin shëndetësor, në mënyrë të posaçme mjekëve dhe farmacistëve. Përmes saj synohet gjithashtu transparencë ndaj publikut, lidhur me barnat që rimbursohen nga shteti.

Dr. ASTRIT BECI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Shtypi u realizua në Shtypshkronjën “KRISTALINA - KH”

SQARUESE MBI PËRDORIMIN E LBR 2014

Lista e barnave të rimbursuara është një element i rëndësishëm bazë në të cilin e mbështesin punën e tyre mjekët, farmacistët, depot farmaceutike importuese/distributore, agjencitë farmaceutike, që kanë kontratë me FONDIN E SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR

Kjo listë është konceptuar në bazë të klasifikimit të Sistemit ATC (anatomik, terapeutik dhe kimik).

Per t'ju ardhur në ndihmë farmacistëve, mjekëve si dhe punonjësve të DRSKSH-ve gjatë aktivitetit për realizimin e rimbursimit të barnave janë pasqyruar materialet e mëposhtëme:

1. Sqaruese mbi përdorimin e LBR 2014.
2. Disa njohuri mbi Sistemin ATC të klasifikimit të barnave.
3. Lista e barnave të rimbursuara 2014, sipas klasifikimit ATC me strukturën e çmimeve (çmimi referencë, çmimi i pacientit, çmimi i rimbursimit).
4. Barnat e rimbursuara që tregëtohen në farmacinë e QSUT 2014, sipas klasifikimit ATC me strukturën e çmimeve (çmimi referencë, çmimi i pacientit, çmimi i rimbursimit).
5. Barnat e rimbursuara që tregëtohen në Farmacitë e Spitaleve Rajonale 2014, sipas klasifikimit ATC me strukturën e çmimeve (çmimi referencë, çmimi i pacientit, çmimi i rimbursimit).
6. Lista e barnave të rimbursuara 2014, sipas klasifikimit ATC, me çmimin e depos.
7. Lista e barnave të rimbursuara 2014, sipas rendit alfabetik.
8. Lista e firmave prodhuese dhe mbajtësit të autorizuar për tregëtim të përfaqësuar në LBR 2014.

Çmimet e barnave të kësaj liste janë të bazuara në informacionin e marrë nga Komisioni i Çmimit të Barnave pranë Ministrisë së Shëndetësisë .

Për të gjithë barnat e listës janë zbatuar marzhe fitimi 8 % për shitjen me shumicë dhe 24% për shitjen me pakicë, përjashtuar barnat e pasqyrës II për të cilat janë aplikuar marzhe të diferencuara. Gjithashtu për të gjitha barnat që tregëtohen vetëm në farmacinë e QSUT dhe në farmacitë e Spitaleve Rajonale, të paraqitura më vehte në fletët me ngjyrë, është aplikuar marzhi 5.5% për shitjen me shumicë.

Për barnat e paregjistruara, por me leje importi, të miratuara nga Komisioni Teknik i Barnave, është përdorur simboli *.

Kursi i këmbimit të përdorur është 1Euro =140.3lek dhe 1\$=104.6lek.

Sigurimet shëndetësore rimbursojnë sipas masës së mbulimit të përcaktuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr 135 të datës 12/03/2014, alternativën e parë të çdo bari. Alternativat e tjera të renditura gjithmonë pas të parës u përkasin firmave të tjera farmaceutike, dhe nëse

Për të lehtësuar përdorimin e listës po japim një shëmbull të marrë nga kjo listë:

Kodi i Barit	KodiEmërtimi ATC Kimik	Forma	Emri Tregëtar	Firma Farma- ceutikeReferencë	Çmimi Pacientit	Çmimi Rimbursimit	
89/200	C10AA04 Fluvastatine hard 40 mgcaps.		Fluvastatine Actavis	ACTAVIS	19.4	9.7	9.7
89/38	C10AA04 Fluvastatine hard 40 mgcaps.		Fluvastatine EG	EG LABO	29.5	19.8	9.7
89/184	C10AA04 Fluvastatine hard 40 mgcaps.		Fluvastatin 1A Pharma	1A PHARMA	37.6	27.9	9.7
89/92	C10AA04 Fluvastatine caps. 40 mg		Lescol	NOVARTIS	42.5	32.8	9.7

P.sh. n.q.s i siguruari dëshiron të marrë Fluvastatine EG ai do të paguajë $29.5 - 9.7 = 19.8$ lekë për tabletë. (referuar tabelës së mësipërme).

Masa e mbulimit të çmimit të barnave në listë, sipas grupeve të caktuara varion në masën 50%-100%.

Kategoritë shoqërore të tilla si pensionistë; invalidë të plotë; fëmijë 0-12 muaj; të sëmurë me CA, TBC; Jetimë; Të verbër; Raste të veçanta; ashtu si më parë do të vazhdojnë të marrin falas alternativën e parë të çdo bari të përfshirë në këtë listë .

Kategoritë shoqërore Veteranë dhe Invalidë të Luftës do të vazhdojnë të marrin falas çdo alternativë të barit (brenda ose jashtë listës së barnave të rimbursuara), sipas përshkrimit në recetën me rimbursim nga ana e mjekut, në përputhje me aktet ligjore ne fuqi.

Në asnjë rast nuk lejohet llogaritja e dozave me shumëfishin apo nënfishin e dozës së barit në listë, për asnjë lloj forme farmaceutike të barit.

Kufizimet e përdorimit të barnave të listës janë kufizime në indikacione, në sasi dhe në kohën e trajtimit.

Në aktivitetin e rimbursimit, do të merren në konsideratë për rimbursim vetëm barnat e përcaktuara në këtë listë.

DY FJALË MBI SISTEMIN E KLASIFIKIMIT A.T.C. TË BARNAVE

Lista e barnave të rimbursuara nga FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDES-IT SHËNDETËSOR është ndërtuar sipas klasifikimit A.T.C. (anatomik, terapeutik, kimik) të barnave.

Kjo Listë synon që t'u krijojë mjekëve e farmacistëve mundësinë e orientimit më të mirë dhe të përdorimit në mënyrë sa më efektive.

A.T.C është një sistem i klasifikimit të barnave i hartuar nën rekomandimin dhe kujdesin e Organizatës Botërore të Shëndetësisë dhe të Këshillit Nordik të Barnave.

Sipas këtij sistemi klasifikimi, barnat ndahen në grupe të ndryshme në përputhje me sistemin, organin në të cilin veprojnë, efektin e tyre kimik, farmakologjik dhe terapeutik.

Barnat klasifikohen në grupime sipas pesë niveleve, duke pasur kështu kodet e tyre përkatëse.

- Në nivelin e parë përfshihet GRUPI KRYESOR ANATOMIK i shprehur si më poshtë:

- A. Trakti digjestiv dhe metabolizmi.
- B. Gjaku dhe organet hemopojetike.
- C. Sistemi kardiovaskular.
- D. Dermatologjikët.
- G. Sistemi urogjenital dhe hormonet seksuale.
- H. Preparatet hormonale sistemike, përjashtuar hormonet seksuale.
- J. Antiinfektivët e përgjithshëm sistematik.
- L. Barnat antineoplazike dhe imunosupresore.
- M. Sistemi muskulo-skeletik.
- N. Sistemi nervor.
- P. Produktet antiparazitare.
- R. Sistemi respirator.
- S. Organet e shqisave.
- V. Të ndryshme.

- Në nivelin e dytë përfshihet GRUPI KRYESOR TERAPEUTIK.
- Në nivelin e tretë përfshihet NËNGRUPI FARMAKOLOGJIKO-TERAPEUTIK.
- Në nivelin e katërt përfshihet NËNGRUPI FARMAKOLOGJIK.

- Në nivelin e pestë përfshihet NËNGRUPË KIMIK.

Për të ilustruar strukturën e kodit ATC, marrim si shëmbull barin Atenolol. Ky preparat në sistemin e klasifikimit ATC ka kodin C07AB03 të shpjeguar si më poshtë:

- C. SISTEMI KARDIOVASKULAR
(niveli i parë - grupi kryesor anatomik)

- C07. BETABLLOKUESIT .
(niveli i dytë- grupi kryesor terapeutik)

- C07A. BETABLLOKUESIT E RECEPTORËVE BETA-ADRENERGJIKË
JOSELEKTIVË
(niveli i tretë – nëngrupi farmakologjiko-terapeutik)

- C07AB. BETABLLOKUESIT E RECEPTORËVE BETA-ADRENERGJIKË .
SELEKTIVË
(niveli i katërt – nëngrupi kimik-farmakologjik)

- C07AB03. Atenolol
(niveli i pestë – nëngrupi kimik)

Barnat në këtë sistem klasifikohen në përputhje me përdorimin terapeutik kryesor të përbërësit kryesor aktiv, sipas parimit bazë që çdo bar të ketë një kod të vetëm. Megjithatë një bar mund të ketë më shumë se një kod ATC, në varësi të formave farmaceutike të përdorimeve terapeutike që ka. Si p.sh bari Gentamicinë në përdorimin në dermatologji në formë pomade bën pjesë në grupin kryesor anatomik D, në okulistikë në formë koliri, në grupin S, si antiinfektiv, në grupin J.

LISTA E BARNAVE TË RIMBURSUARA 2014